

VENDIM
Nr. 738, datë 12.12.2025

**PËR PËRTHITHJEN E DREJTORISË SË SHËRBIMIT TË TRUPIT
DIPLOMATIK NGA DREJTORIA E SHËRBIMEVE QEVERTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 33, të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar; të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përthithjen e Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik (në vijim, DSHTD) nga Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare (në vijim, DSHQ) dhe kryerjen e të gjitha procedurave për transferimin e funksioneve institucionale nga DSHTD-ja tek DSHQ-ja.

2. DSHQ-ja kryen procedurat në funksion të trajtimit të punonjësve të DSHTD-së sipas nevojave të institucionit të DSHQ-së, në përshtatje të realizimit të funksionit institucional, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Punës.

3. Procedurat për trajtimin e punonjësve të DSHTD-së përfundojnë brenda datës 31.12.2025, por duke respektuar, në çdo rast, parashikimet e Kodit të Punës e duke u paguar atyre të gjitha detyrimet e parashikuara nga dispozitat e tij, sipas rastit.

4. Pasuritë e paluajtshme, aktualisht në përgjegjësi administrimi të DSHTD-së, kalojnë në përgjegjësi administrimi të Këshillit të Ministrave për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, së bashku me të gjitha të drejtat e detyrimet e tjera, që lidhen me to. Kalojnë në përgjegjësi administrimi të DSHQ-së edhe të gjitha sendet e luajtshme të DSHTD-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. DSHTD-ja përgatit inventarët e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe kryen të gjitha procedurat, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. DSHQ-së i kalojnë të gjitha të drejtat e detyrimet, që lidhen me këto sende, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Dokumentacioni arkivor dorëzohet sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për arkivat.

7. Ngrihet komisioni i likuidimit të DSHTD-së, i përbërë nga 7 (shtatë) anëtarë, i cili do të përgatisë bilanci të likuidimit, inventarizimin e pasurisë, mbylljen e kontratave, përgatitjen e pasqyrave financiare dhe dorëzimin të DSHQ-ja brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Pasqyrimi të DSHQ-ja bëhet me pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2025.

8. Pas përfundimit të likuidimit, Komisioni depoziton dokumentacionin për çregjistrimin e ndërmarrjes në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

9. Në vendimin nr. 840, datë 17.12.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) në titullin e vendimit dhe kudo në tekst, emërtesa “Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik” dhe shkurtesa “DSHTD” zëvendësohen me fjalët “struktura përgjegjëse për shërbimin e trupit diplomatik në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare”;

b) pika 1 shfuqizohet.

10. Në shkronjën “k”, të pikës 2, të vendimit nr. 34, datë 7.1.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare dhe trajtimin e personaliteteve të larta të Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar, fjalët “... nëpërmjet drejtorisë përkatëse në varësi të saj ...” zëvendësohen me “... nëpërmjet strukturës përgjegjëse në përbërje të saj ...”.

11. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama